

**ALBULENA PLLANA BREZNICA,
SADETE PLLANA**

**MËSIMI I AQS-SË (ANGLISHTJA PËR QËLLIME SPECIFIKE)
NË SHMT “LUTFI MUSIQI” NË VUSHTRI**

Hyrje

Gjuha angleze ka kohë që është bërë gjuha kryesore për komunikim ndërkombëtar. Sot, sidomos për punësim, **AQS-ja** (*Anglishtja për Qëllime Specifike*) (*ESP-English for Specific Purposes*), po bëhet gjithnjë e më tepër një domosdoshmëri e kërkesave në fillim të këtij mijëvjeçari. Historia e AQS -së nuk është edhe aq e re. Nga literatura e shfletuar, shembujt e parë datojnë që në shek. XIV, për nevoja të tregtarëve, për komunikim në mes anglezëve dhe francezëve¹. Në realitet është vështirë që të nxirret një përfundim se kur ka lindur AQS-ja. Rritja e AQS-së ka filluar në pjesën e dytë të shek. XX (në vitin 1960).

Në të kaluarën, nxënësit kanë mësuar gjatë gjuhën e përgjithshme angleze (AQP) për profesione të ndryshme, e cila nuk ka qenë gjithmonë ndihmë e madhe kur ajo është zbatuar për fusha të ndryshme të specializimit, të tilla si: inxhinieri, turizëm, shkencë e teknologji, mjekësi, e kështu me radhë. Ky numër i profesioneve të ndryshme nxori nevojën për specializim të AQS-së (ESP), disa karakteristika të përbashkëta të saj, për nevoja të veçanta, fjalorë të specializuar teknikë dhe dokumentacione teknike, mjedise specifike të punës, etj.

Çfarë është AQS-ja (ESP)?

Nevoja për zhvillimin e AQS-së (ESP) është reflektuar edhe në rritjen e numrit të kolegjeve dhe universiteteve që ofrojnë diploma Master nga AQS-ja (ESP).

Hutchinson dhe Waters² e përkufizojnë AQS-në (ESP) duke u shprehur: “...AQS-ja (ESP) duhet parë si qasje dhe jo si produkt. AQS-ja (ESP) nuk është një lloj gjuhe apo metodologjie e veçantë dhe as nuk konsiston në një lloj të veçantë materiali. Ajo është një qasje për mësimin e

¹ A. Howat, *A history of English language teaching*, Oxford University Press, 1984, f. 5-6.

² 1. T. Hutchinson & A. Waters, *English for Specific Purposes: A learning-centered approach*. Cambridge: Cambridge University Press, 1987, f. 19. 2. V. Kanini (Bulimani), *Zhvillime bashkëkohore në ESP*, dis. UT, Tiranë, 2015, f. 7.

gjuhës, ku në qendër janë nevojat e nxënësve...” si qasje, dhe jo si një produkt, që do të thotë se AQS-ja (ESP) nuk përfshin ndonjë lloj të veçantë të gjuhës, materialeve ose metodologjisë, por dedikimi kryesor, respektivisht, përse nxënësi ka nevojë për të mësuar një gjuhë të huaj. Sipas Robinson³ AQS-në (ESP) e karakterizojnë dy kritere:

- a) AQS-ja (ESP) është kthyer drejt qëllimit dhe
- b) kurset e AQS-së (ESP) po zhvillohen në bazë të analizës së nevojave, të cilat ne mund t'i gjejmë, se çfarë nxënësit (studentët) duhet të bëjnë me gjuhën angleze. AQS-në (ESP) ende e emërtojnë “*zbatim i anglishtes së përgjithshme*”, për shkak se përmbajtja dhe qëllimi i mësimdhënies konfirmohet sipas kërkesave të grupeve. E rëndësishme është që të nxitet nevoja e nxënësve (studentëve), natyrisht, për zgjerimin e njohurive, çfarë e bën AQS-në (ESP) të përzemërt për nxënës (studentë).

Sipas Carver⁴ ekzistojnë tri karakteristika kryesore të mësimdhënies së AQS-së (ESP):

- a) përdorimi i materialit autentik, të cilin mësimdhënësi mund ta modifikojë,
- b) orientimi në qëllimin për të cilin nxënësit (studentët) janë të trajnuar për situatat e komunikimit dhe
- c) shndërrimi i nxënësve (studentëve) nga mësimnxënia në përdorues, çfarë përfshin stimulimin e nivelit të caktuar të autonomisë në mesin e nxënësve (studentëve).

T. Dudley-Evans & M. St John⁵, kanë prezantuar karakteristikat absolute dhe të ndryshueshme të AQS-së (ESP).

Karakteristikat absolute janë:

- a) AQS-ja (ESP) është projektuar (dizajnuar) për të përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve (studentëve);
- b) AQS-ja (ESP) shfrytëzon metodologjitë dhe aktivitetet e disiplinës për të cilën shërben,
- c) AQS-ja (ESP) është e fokusuar në gjuhën e përshtatshme për këto aktivitete, për sa i përket gramatikës, leksikut, regjistrave, shkathtësive, diskurseve dhe zhanreve.

³ P. Robinson, *ESP today: a Practitioner's Guide*. Hemel Hempstead: Prentice Hall International, 1991, f. 112.

⁴ D. Carver, *Some propositions about ESP*. The ESP Journal, 2, 1983., f. 131-137.

⁵ T. Dudley-Evans & M. St John, *Developments in ESP: A multi-disciplinary approach*. Cambridge: CUP. 1998, f. 4-5.

Karakteristikat e ndryshueshme të AQ-së (ESP) janë:

- a) AQS-ja (ESP) mund të jetë e dizajnuar për disiplina të veçanta;
- b) AQS-ja (ESP) mund të shfrytëzojë, në situata të veçanta, metodë të ndryshueshme nga Anglishtja për Qëllime të Përgjithshme (AQP);
- c) AQS-ja (ESP) është projektuar kryesisht për të rriturit, në institucionet në nivel terciar, në situatat e punës profesionale. Ajo gjithashtu mund të jetë edhe për nivelin e nxënësve për shkollat e mesme;
- d) AQS-ja (ESP) është projektuar zakonisht për nxënësit (studentët) me dituri mesatare dhe të avancuar;
- e) Shumica e kurseve të AQS-së (ESP) përfshijnë njohuri themelore të sistemeve të gjuhës.

Kjo ndarje e AQS-së (ESP) në karakteristikat absolute dhe të ndryshueshme është shumë e dobishme për zgjidhjen e pavendosmërive se çfarë është AQS-ja (ESP), dhe çfarë nuk është. Mund të shohim se AQS-ja (ESP) mund, por nuk duhet, të jetë e lidhur me ndonjë disiplinë, dhe kjo mund të mos jetë e zbatueshme për ndonjë grup moshe.

Një numër i caktuar artikujsh për AQS-në (ESP) janë botuar edhe nga profesorë shqiptarë në Shqipëri⁶, Kosovë⁷ dhe Maqedoni (B. Xhaferi, A. Poshka), të cilët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë kësaj fushe të gjuhës për qëllime specifike.

Një nga AQS-të (ESP) është edhe anglishtja për shkollat profesionale teknike, në rastin konkret, për nxënësit e shkollës së mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri (Republika e Kosovës), drejtimet: makineri, elektroteknikë, mekatronikë dhe komunikacion. Kjo është një gjuhë e

⁶ 1. A. Duro & F. Vrap, *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe*, në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra”, Konferencë shkencore, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2009, f. 197-211. 2. V. Kanina (Bilimani), *Zhvillime bashkëkohore të ESP*, disertacion UT FGJH DGJA, Tiranë, 2015. 3. M. Paci & Sh. Delija & S. Vishkurti, *The Development of an English for Specific Purposes Curriculum in the Polytechnic University of Tirana*, International Journal of Humanities Social Sciences and Education, Vol. 1, Issue 8, August 2014, p. 193-199.

⁷ 1. A-B. Pllana, *Teaching ESP in some departments of the Prishtina University “Hasan Prishtina”*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol. 5, No. 1, March 2016, p. 65-71. 2. Sh. Germizaj & Sh. Hoxha, *“Student’s Perception of the ESP Courses at the University of Prishtina”*, Ilira International Review-2014/1 Felix-Verlag, Holzkirchen, Germany and Iliria College, Prishtina, Kosovo.

projektuar për këto profesione (kryesisht për klasat e dymbëdhjeta), që iu bënë të mundur nxënësve shfrytëzimin e literaturës teknike nga interneti dhe punësimin në vendet në zhvillim në Evropë e gjetiu. Karakteristikë e gjuhës angleze të këtyre profesioneve është specifika në atë, që repertori është i kufizuar dhe mund t'u përshtatet situatave. Ky repertor është i ndarë nga e gjithë gjuha, por kjo nuk është me të vërtetë një gjuhë, sepse njohja e këtij repertori të kufizuar nuk lejon folësin për të komunikuar në një situatë të re, ose në mjedisin jashtë profesionit të tij. Në punën me nxënës të kësaj shkolle, përveç leksikut të përgjithshëm të gjuhës angleze, në bashkëpunim edhe me kolegët tjerë që japin mësim, kemi futur një numër të caktuar të fjalëve dhe termave teknike në programet mësimore.

Në çfarë ndryshon mësimdhënia e AQS-së (ESP) nga mësimdhënia e Anglishtes për Qëllime të Përgjithshme (AQP) (EGP-English for General Purposes)?

T. Hutchinson & A. Waters⁸ janë përgjigjur në këtë pyetje "*në teori asgjë, në praktikë shumë.*" Së pari duhet theksuar se AQS-ja (ESP) është aktivitet i veçantë brenda AQP-së, edhe pse kufiri ku mbaron mësimdhënia e AQP-së, dhe fillon AQS-ja (ESP), është shumë i paqartë.

Dallimi më i rëndësishëm qëndron tek nxënësit (studentët) dhe qëllimeve të tyre. Nxënësit (studentët) e AQS-së (ESP) janë zakonisht njerëz të rritur (edhe pse sot ka shumë nxënës (studentë) të rinj të AQS-së (ESP)), tashmë, me disa njohuri themelore të gjuhës angleze, qëllimi i të cilëve është të mësojnë një gjuhë, që ata mund ta përdorin në vendin e punës (të tanishëm ose të ardhshëm). Gjithashtu, më pak kohë i përkushtojnë gramatikës dhe strukturave të gjuhës, dhe më shumë gjuhës në kontekst, edhe pse kjo marrëdhënie mund të ndryshojë. Çështja është se gjuha angleze nuk është mësuar veçmas nga bota reale e nxënësit (studentit), por si pjesë e saj. Shumë shpesh, nxënësit (studentët) janë të motivuar për të mësuar AQS-në (ESP), sepse kombinojnë gjuhën angleze me materien që është e njohur për ta. Në të vërtetë, shpesh nxënësit (studentët) zbatojnë gjuhën angleze për atë, që ata mësojnë në fushën e tyre kryesore. Për më tepër, dija e tyre për materien, shpesh u shërben për të mësuar më mirë gjuhën angleze, sepse ajo u jep atyre kontekstin e duhur me të cilin ata përballen. Këtë fakt mësimdhënësit e mirë duhet ta shfrytëzojnë.

⁸ T. Hutchinson & A. Waters, *English for Specific Purposes: A learning-centered approach*. Cambridge: Cambridge University Press, 1987, f. 19.

Megjithatë, nuk ndryshon AQP-ja nga AQS-ja (ESP), vetëm nga nxënësit (studentët), por edhe për qëllime të mësimdhënies. Në AQP, qëllimi ynë është që të punojmë në mënyrë të barabartë në të katër shkathtësitë gjuhësore: *lexim*, *shkrim*, *dëgjim* dhe të *folur*. Tek AQS-ja (ESP), së pari duhet vërtetuar se cila është shkathtësia më se e nevojshme për një grup të veçantë të nxënësve (studentëve) dhe më pas të insistohet në të.

Në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, në klasat e dhjeta e të njëmbëdhjeta mësohet AQP-ja, kurse në klasat e dymbëdhjeta, në të gjitha drejtimet, zbatohet AQS-ja (ESP). Mësimdhënia në këto drejtime, natyrisht, ndryshon në fusha të ndryshme, orientimi drejt qëllimit, përdorimi i materialeve autentike, duke u fokusuar në një fjalor tjetër, gramatikë etj.

Kush duhet të jetë mësimdhënës i AQS-së (ESP)?

Shpesh bëhet pyetja, se kush duhet të ligjërojë AQS-në (ESP). A duhet të jetë një ekspert në mësimdhënien e gjuhës angleze apo ekspert në një profesion të caktuar? Mendimi i përgjithshëm është, se duhet të jetë një ekspert gjuhe dhe mësimdhënës i gjuhës angleze, të paktën me disa njohuri për një profesion të caktuar dhe një interes të sinqertë për të.

Mësimdhënësit e AQS-së (ESP) nuk janë ekspertë të fushës, por specialistë në mësimdhënie të gjuhës angleze. Ata duhet të ndihmojnë nxënësit (studentët) në zhvillimin e shkathtësive, të cilat atyre do t’u mundësojnë shfrytëzimin e gjuhës angleze në profesionin e tyre. Gjithashtu, mësimdhënësit e AQS-së (ESP) duhet të jenë në gjendje për të ligjëruar në gjuhën angleze për cilindo profesion (fushë) pa shumë përgatitje. E gjithë ajo që duhet bërë, është zbatimi i parimeve ekzistuese në kuadër të materies së re.

Hulumtimi i kryer tek nxënësit, në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, klasa e dymbëdhjetë (elektroteknikë, gjithsej 32 nxënës, fig. 1.) tregon se rezultate më të mira në të nxënit e gjuhës angleze janë arritur kur ligjëron mësimdhënësi i gjuhës angleze, sesa kur ligjëron eksperti i një fushe të veçantë (specialist i elektroteknikës). Kjo tregon, se mësimdhënia e AQS-së (ESP) nuk është thjesht një profesion i mësimdhënies së gjuhës angleze, por është e përzier me përmbajtjen e përgjithshme.




Fig. 1. Rezultatet e të nxënit të gjuhës angleze, kl. XX/elektroteknikë, me mësimdhënës të gjuhës anglez dhe specialistit të fushës

Në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtri mësimin e gjuhës angleze e zhvillojnë mësimdhënësit e gjuhës angleze, pra jo ekspertët (inxhinierët) e fushave të drejtimeve teknike, të cilat janë në programin e shkollës. Natyrisht, kolegët më të vjetër tashmë kanë njohuri solide të profesioneve teknike, dhe të gjithë së bashku perfeksionohemi për fushat teknike, vizita në punëtori të qytetit, duke dëgjuar leksionet e kolegëve tanë më të vjetër, me qëllim që çdo vit të zvogëlohet hendeku në mes të diturisë nga fusha e mësimdhënësve të gjuhës angleze dhe ekspertëve nga fushat e ndryshme teknike pranë shkollës sonë.

Roli nxënësve (studentëve) dhe mësimdhënësve në mësimdhënie të AQS-së (ESP)

Mësimdhënësi shpesh varet nga njohuritë e nxënësve (studentëve) në procesin mësimor, dhe marrëdhënia e tyre është më shumë si një partneritet. Mësimdhënësi duhet të jetë fleksibil, i interesuar për fushën me të cilën merren nxënësit (studentët), e nganjëherë të marrë rreziqe në të mësuarit e tyre.

Mësimdhënësi duhet të jetë kreator i mësimdhënies. Shpesh është e vështirë për të gjetur materiale mësimore për profesionet e caktuara, dhe kur gjenden ato, janë të nevojshme edhe materiale të tjera shtesë.

Mësimdhënësi i AQS-së (ESP) duhet të gjejë materialet e nevojshme, të hartojë planprogramin e vet, t'i përshtatë materialet e nevojshme, të

bashkëpunojë me një ekspert të fushës dhe ndonjëherë edhe t’i përshkruaj materialet e duhura.

Motivimi i nxënësve (studentëve) duhet të jetë i lartë në orën e gjuhës angleze të profesioneve teknike, sepse nxënësit e dinë se AQS-ja (ESP) është kusht themelor për profesionin e tyre në të ardhmen.

Problemet në mësimdhënie dhe masat për përmirësim

Në mësimdhënien e gjuhës angleze në drejtimet teknike në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, hasim pengesat e mëposhtme për mësimdhënësit:

- Mungesa e traditës së mësimdhënies së AQS-së (ESP);
- Mungesa e materialeve me cilësi të lartë;
- Mungesa e kohës;
- Zvogëlimi i statusit të lëndës dhe mësimdhënësve;
- Nganjëherë një mungesë respekti nga ana e nxënësve.

Problemi i mungesës së traditës së AQS-së (ESP) është i kuptueshëm për shkak të ekzistencës relativisht të shkurtër të AQS-së (ESP). Sa për mungesën e njohurive profesionale, ajo mund të jetë disi e bërë në bashkëpunim me një ekspert të një fushe të caktuar, por me kalimin e kohës mësimdhënësi do të kapërcejë më shumë njohuri në fushën përkatëse. Një nga problemet më të mëdha për mësimdhënësit e AQS-së (ESP) është mungesa e kohës për të kryer një analizë të nevojave, kërkimit dhe përshtatjes së materialit, veçanërisht në qoftë se mësimdhënësi duhet shpesh të ndryshojë profesionin e mësimdhënies së gjuhën angleze për drejtimet e parapara në programin e shkollës.

Mungesa e respektit nga ana e nxënësve mund të shfaqet tek disa nxënës, që fitojnë përshtypjen, se mësimdhënësit nuk janë mjaft të përgatitur në gjuhën angleze për fushën e tyre.

Andaj, mësimdhënësi AQS-së (ESP) duhet të bashkëpunojë me ekspertë të një fushe të caktuar, dhe të monitorojë reagimet e nxënësve.

Përfundimisht duhet të rritet besimi, se një mësimdhënësi zotëron “profesion të ri”, duke punuar me profesionistë dhe të mësojë nga nxënësit e vet.

Problemi më i madh është mungesa e kohës, për shkak se të gjitha problemet e tjera mund të jenë të zgjidhshme.

Materialet mësimore për mësimdhënie të AQS-së (ESP)

Shumë e rëndësishme në mësimdhënie të AQS-së (ESP) është përzgjedhja, përshtatja dhe hartimi i materialeve mësimore. Pyetjet më të rëndësishme janë:

- Si duhet t'i përdorë nxënësi njohuritë specifike të gjuhës angleze?
- Çfarë aftësish duhen zotëruar, dhe në çfarë niveli?

Përzgjedhja e teksteve mësimore

Një mësimdhënës duhet të marrë parasysh disa çështje:

- A do të jenë materialet të dobishme për nxënësit?
- Si të rritet kureshtja e nxënësve për AQS-në (ESP)?
- A janë materialet të përshtatshme për nxënësit dhe për nevojat e tyre?

Materialet duhet të jenë autentike (nxënësit duhet të njihen me material autentik), azhure (informacioni mund të shkëmbehet) dhe relevante (duhet të lidhen me profesionin e tyre të synuar).

Detyra e shtëpisë së nxënësve mund të jetë për të sjellë ndonjë dokument të përdorur në profesionin e tyre, dhe nga këto mësimdhënës të përcaktojnë se ç'materiale janë të përshtatshme për mësimdhënie. Pra, materialet për mësimdhënie të AQS-së (ESP) duhet të sigurohen nga një ekspert i një fushe të veçantë, sepse mësimdhënësit e AQS-së (ESP) nuk mund të mbështeten në përvojën e tyre personale.

Nga ana tjetër, për disa profesione është vërtetë e vështirë për të gjetur tekste të gatshme, të cilat, pastaj, duhet kombinuar me materialet e reja.

Një nga çështjet kryesore për zgjedhjen e materialeve për mësimdhënie të AQS-së (ESP) është raporti i materialeve të përzgjedhura mësimore të përgjithshme në krahasim me materiale profesionale. Është mirë, që të përdoren materialet, që nuk janë të përgatitura gjithmonë me qëllim për mësimin e gjuhës. Zakonisht këto materialet mund të sigurohen përmes emisioneve audio-vizuale, nga gazetatat, revistat, radio, TV, interneti, libra, dokumente të ndryshme etj.

Sfida më e madhe është të zgjedhësh atë që është më e përshtatshme.

Përfundim

AQS-ja (Anglishtja për Qëllime Specifike) (**ESP- English for Specific Purposes**) në vitet e fundit është bërë shumë e rëndësishme për shkak të rritjes së formimit profesional në tërë botën, me rritjen dhe përhapjen e gjuhës angleze si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, dhe për shkak se nxënësit mësojnë gjuhën angleze në moshë më të re, e kështu më herët kalojnë në mësimin e AQS-së (ESP).

Hulumtimi i kryer, tek nxënësit në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, klasa e dymbëdhjetë, tregon se rezultate më të mira në të nxënit e gjuhës angleze janë arritur kur ligjëron mësimdhënësi i

gjuhës angleze sesa kur ligjëron eksperti i një fushe të veçantë (rast konkret specialisti i elektroteknikës). Kjo tregon se mësimdhënia e AQS-së (ESP) nuk është thjesht një profesion i mësimdhënies së gjuhës angleze, por është e përzier me përmbajtjen e përgjithshme.

Vetë mësimdhënësit duhet, nëse është e mundur, të jenë ekspertë në gjuhë, por jo edhe ekspertë të fushës. Sigurisht ka probleme në mësimdhënie të AQS-së (ESP), për shkak të sasisë së materialeve, e ndoshta edhe për mungesë të kohës. Duhet pasur kujdes, për shkak të rritjes së sasisë së materialit të papërshtatshëm, në zgjedhjen e materialit adekuat për moshën, fushën e studimit, dhe të kohës. Përfundimisht AQS-ja (ESP) është një fushë në rritje, e të mësuarit e gjuhës angleze, me një të ardhme të ndritshme.

BIBLIOGRAFI

- Carver, D. (1983), *Some propositions about ESP*. The ESP Journal, 2.
- Dudley-Evans, T. & St John, M. (1998), *Developments in ESP: A multi-disciplinary approach*. Cambridge: CUP.
- Dudley-Evans, T. (2001), *English for specific purposes*. Cambridge University Press.
- Duro, A.&Vrap, F. (2009), *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe*, në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra”, Konferenë shkencore, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë.
- Germizaj, Sh. & Hoxha, Sh. (2014), *Student's Perception of the ESP Courses at the University of Prishtina*, Ilira International Review-2014/1 Felix-Verlag, Holzkirchen, Germany and Iliria College, Prishtina, Kosovo.
- Hutchinson, T. & Waters, A. (1987), *English for Specific Purposes: A learning-centered approach*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Kanina (Bilimani) V.(2015), *Zhvillime bashkëkohore të ESP*, disertacion UT FGJH DGJA, Tiranë.
- Paci, M. & Delija, Sh. & Vishkurti, S. (2014), *The Development of an English for Specific Purposes Curriculum in the Polytechnic University of Tirana*, International Journal of Humanities Social Sciences and Education, Vol. 1, Issue 8.
- Pllana, A-B. (2016). *Teaching ESP in some departments of the Prishtina University* “Hasan Prishtina, Academic Journal of

Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Vol. 5, No. 1, March 2016, Rome-Italy, Robinson, P. (1991). *“ESP today: a Practitioner's Guide”*. Hemel Hempstead: Prentice Hall International.